

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2022

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	11.01.2022	Informacion në lidhje me pastrimin: vlera e buxhetit për pastrimin nga mbetjet për periudhën 2014-2022, venddepozitimi i mbetjeve, djegia e mbeturinave, numri i koshave dhe punëtorëve të pastrimit etj.	12.01.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 11.01.2022, ju bëjmë me dije se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nga viti 2014-2018 vlera e buxhetit për pastrimin nga mbetjet është 52.450.000 lek në vit. Ndërsa nga viti 2019 dhe në vazhdim është 79.600.000 lek në vit. 2. Bashkia Korçë bën depozitimin e mbetjeve në Landfillin e Maliqit. 3. Pika fundore e vendosur në dispozicion përsa i përket depozitimit të mbetjeve është Landfilli. 4. Bashkia Korçë ka aktualisht 1 (një) pikë depozitimi të mbetjeve. 5. Nuk ka asnjë zonë e cila nuk mbulohet nga pastrimi. 6. Po, Bashkia Korçë mbulon me buxhetin e saj pastrimin. 7. Jo, nuk ka djegie të mbeturinave brenda territorit që mbulon Bashkia Korçë. 8. Aktualisht janë 600 kosha për mbeturina dhe 70 punëtorë pastrimi. 9. Këtë vit është planifikuar të fillojë rehabilitimi i fushës së vjetër të mbetjeve në afërsi të qytetit. 	E plotë	S'ka tarifë

2.	17.01.2022	Informacion në lidhje me shpenzimet në buxhet nga viti 2013-2021 për menaxhimin e plehrave dhe mbetjeve urbane.	19.01.2022	Përsëritje! Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 17.01.2022, ju bëjmë me dije se: Nga viti 2013-2018 vlera e buxhetit për pastrimin nga mbetjet është 52.450.000 lek në vit. Ndërsa nga viti 2019 dhe në vazhdim është 79.600.000 lek në vit.	E plotë	S'ka tarifë
3.	27.01.2022	Informacion në lidhje me numrin e nëpunësve të Bashkisë Korçë për muajin Janar 2021, Prill 2021 si dhe për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndësore.	31.01.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 27.01.2022, ju bëjmë me dije se: - Në muajin Janar 2021 numri i nëpunësve ishte 101. - Në muajin Prill 2021 numri i nëpunësve ishte 103. - Bashkia Korçë paguan kontribute gjithsej 16.7 %, e përbërë nga 15% sigurime shoqërore dhe 1.7 % sigurime shëndetësore.	E plotë	S'ka tarifë
4.	27.01.2022	Kërkesë për vendosje në dispozicion të kontratës së lidhur për rikonstruksionin e rrugës "Koço Glozheni" në fshatin Dardhë.	01.02.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 27.01.2022, po ju vendosim në dispozicion Buletinën e njoftimit publik me Nr.89 datë 19.10.2020 të kontratës të nënshkruar "Rikonstruksion i rrugës "Koço Glozheni" fshati Dardhë", fq 426.	E plotë	S'ka tarifë

5.	09.02.2022	Informacion në lidhje me qentë endacakë, sterilizimi dhe vaksinimi i tyre, plani i menaxhimit të Bashkisë si dhe numri i qenve endacakë.	10.02.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 09.02.2022, ju bëjmë me dije se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për rastin e helmimit masiv të qenve Bashkia Korçë nuk ka bërë denoncim në organet kompetente ligjzbatuese, pasi kishim mungesë provash. Kryetari i Bashkisë ka bërë reagimin e tij në lidhje me situatën ku mbante qëndrimin për fenomenin e ndodhur. 2. Bazuar në ligjin për procedurën penale, përgjegjësia është e personit që kryen aktin, dhe e organeve kompetente për zbulimin e këtij akti. 3. Gjatë vitit kalendarik 2020 janë sterilizuar dhe matrikulluar 225 qen endacakë, të cilët pas përfundimit të procedurës së sterilizimit janë rikthyer përsëri në habitatin e tyre. Gjatë vitit kalendarik 2021 janë sterilizuar 125 qen endacakë, me një ndryshim nga viti 2020 pasi qentë e sterilizuar janë të gjinisë femër, për të shmangur riprodhimin dhe tufëzimin e tyre, si dhe uljen e rrezikshmërisë për sjelljet agresive. 4. Për vitin kalendarik 2022 në bashkëpunim dhe me fushatat e ruajtjes dhe kujdesit të kafshëve shtëpiake dhe endacake, po mendohet dhe diskutohet krijimi i një menaxhimi më të mirë nga vitet 2020 dhe 2021. 	E plotë	S'ka tarifë
----	------------	--	------------	---	---------	-------------

				5. Me numërimin që është bërë në lagje të ndryshme të qytetit janë rreth 892 qen endacakë, shifër kjo e cila është e ndryshueshme dhe e pa menaxhueshme në numërim, për shkak të ngjashmërisë fizike dhe lëvizjes së tyre nga një habitat në tjetrin.		
6.	22.02.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion në lidhje me numrin e nxënësve rom dhe egjiptiane të shkollave 9 vjeçare dhe te mesme, të cilët kanë përfituar bursa nga VKM 666 datë 10.10.2019.	07.03.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 22.02.2022, ju bëjmë me dije se: Për vitin shkollor 2021-2022 kanë përfituar bursa 134 nxënës rom dhe egjiptian të shkollave 9-vjeçare, si dhe 20 nxënës rom dhe egjiptianë të cilët ndjekin shkollën e mesme të përgjithshme.	E plotë	S'ka tarifë
7.	17.03.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi numrin e personave me aftësi ndryshe, si dhe numrin e të rinjve me çrregullime të spektrit autik të cilët trajtohen në Bashkinë Korçë.	18.03.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 17.03.2022 , po iu dërgojmë të dhënat mbi numrin e të rinjve me çrregullim të spektrit autik për muajin Janar,Shkurt,Mars 2022.	E plotë	S'ka tarifë
8.	23.03.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) nëse është në funksionim, sa janë kostot e mirëmbajtjes	25.03.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 23.03.2022, ju bëjmë me dije se: 1. Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura është në funksionim të plotë dhe përpunon ujërat e ndotura të qytetit të Korçës.	E plotë	S'ka tarifë

		se tij si dhe a janë të parashikuara ato në buxhetin e Bashkisë.		2. Kostot e mirëmbajtjes dhe operimit të impiantit llogariten 13 mil lekë në vit. Këto kosto nuk janë të përfshira në buxhetin e Bashkisë Korçë.		
9.	12.04.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi OJF të financuara nga bashkia për ofrimin e shërbimeve sociale me fonde të përfituara nga fondi social për vitin 2021, cilat janë OJF fituese si dhe lloji i shërbimit të ofruar për vitin 2021.	19.04.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 12.04.2022, ju bëjmë me dije se: Bashkia Korçë në partneritet me organizatat jo fitimprurëse (OJF) kanë aplikuar në fondi social për pilotimin e Shërbimit Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen. OJF e përzgjedhur nga Bashkia Korçë në ngritjen e Shërbimit Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen është Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS. Shërbimet e ofruar nga OJF gjatë viti 2021 janë: Trajnim Stafi; mentorim i stafit të shërbimit; supervizimi i stafit të shërbimit; hartimi i procedurave, rregulloreve dhe manualeve të shërbimit; trajnimi i familjeve kujdestare profesionale dhe menaxhimi i shërbimit me kohë të pjeshme.	E plotë	S'ka tarifë

10.	17.05.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion në lidhje me numrin e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit që janë dhënë për objekte me sipërfaqe ndërtimi mbi 2000 m ² si dhe sa m ² nga këto ndërtime kanë kaluar në favor të fondit publik të banesave sociale.	19.05.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 17.05.2022, ju bëjmë me dije se: Për vitin 2022 nuk ka asnjë aplikim për leje ndërtimi me sipërfaqe banimi mbi 2000 m ² .	E plotë	S'ka tarifë
11.	23.05.2022	Kërkesë për t'u informuar mbi aktivitetet e Bashkisë Korçë për vitin 2022.	24.05.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 23.05.2022, po ju vendosim në dispozicion kalendarin e aktiviteteve të cilat janë planifikuar të zhvillohen nga Bashkia Korçë për periudhën Qershor-Dhjetor 2022.	E plotë	S'ka tarifë
12.	23.05.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion për emergjencat civile të Bashkisë Korçë: fondi në dispozicion për vitin 2020,2021 dhe 2022; kapaciteti i bashkisë, mbështetja financiare nga pushteti qendror.	26.05.2022	1. Sa është fondi në dispozicion për vitin 2022 për emergjencat civile në Bashkinë Korçë? Fondi në dispozicion për vitin 2022 për emergjencat civile në Bashkinë Korçë është në vlerën 30,438,278 lekë , nga të cilat 26,661,278 lekë janë nga transferta e kushtëzuar dhe 3,777,000 lekë të planifikuara nga të ardhurat e Bashkisë. 2. Sa ka qenë ky fond në vitin 2020 dhe 2021? Ky fond në vitin 2020 ka qenë në vlerën 6,391,979 lekë nga të cilat : - 5,022,209 lekë nga transferta e kushtëzuar për Pagesën e familjeve të	E plotë	S'ka tarifë

			<p>dëmtuara nga fatkeqësi natyrore (tërmeti) dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1,369,770 lekë nga të ardhurat e Bashkisë për Ndihmë financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri. <p>Ky fond në vitin 2021 ka qenë në vlerën 15,064,306 lekë nga të cilat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3,829,735 lekë nga transfertat e kushtëzuar për Ndihmë financiare familjeve që ju dëmtuan banesat nga fatkeqësi të ndryshme (tërmeti) dhe dëmet e shkaktuara nga zjarri, - 907,947 lekë nga transfertat specifike, për Shpenzime në situata të vështira dhe fatkeqësi (familjet e dëmtuara nga tërmeti), 9,588,000 lekë për blerje automjete zjarrfikëse, si dhe - 738,624 lekë nga të ardhurat e Bashkisë, për Ndihmë financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri. <p>3. Cili është kapaciteti i bashkisë për emergjencat civile (punonjës, pajisje teknike, logjistike etj)?</p> <p>Pranë Bashkisë Korçë për përballimin e emergjencave civile është ngritur struktura në nivel sektori, konkretisht në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Sektori i Emergjencave Civile, me përbërje 1 Përgjegjës Sektori dhe 2 Specialist, gjithsej 3 punonjës. Pranë kësaj strukturë aktualisht është punësuar një Specialist për Emergjencat Civile.</p>	
--	--	--	---	--

			<p>Në lidhje me kapacitetet logjistike për përballimin e emergjencave civile apo fatkeqësive, Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit pranë Bashkisë Korçë disponon si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> · 8 automjete zjarrfikëse prej të cilave 4 automjete zjarrfikëse janë marrë në fillim të vitit 2022. Të gjitha automjetet janë në gjendje pune dhe të pajisura me pajisjet e nevojshme zjarrfikëse; · 2 automjete shpëtimi në gjendje pune dhe një autoshkallë, pra në total ka 11 automjete; · Pompa lëvizëse thithje uji 3 copë; · Lopata zjarrfikëse për shuarjen e zjarrit 10 copë; · Pompa shpine për shuarjen e zjarrit në pyje 12 copë; · Barela transporti 5 copë; · Aparate frymëmarrje 8 copë; · Ventilator thithje tymrash 1 copë. <p>Për sa i përket kapacitetit ujëmbajtës të automjeteve zjarrfikëse, është në total 35000 litra ujë. Në lidhje me personelin zjarrfikës operues-luftues-shpëtues pranë kësaj drejtorie kemi 27 punonjës të nivelit bazë dhe 4 të nivelit të mesëm, pra në total 31 punonjës.</p> <p>4. A ka bashkia kapacitete të mjaftueshme për të përballuar</p>	
--	--	--	--	--

				<p>fatkeqësitë natyrore të tilla si zjarre, përmytje, tërmetet etj.?</p> <p>Bashkia Korçë në zbatim të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” me qëllim marrjen e masave të nevojshme teknike dhe organizative për përballimin e situatave emergjente ka krijuar një program masash, ndër të cilat është krijuar dhe Komisioni i Mbrojtjes Civile.</p> <p>5. Sa është mbështetja financiare e marrë nga pushteti qendror për këtë vit për emergjencat civile? Për vitin 2022 fondi i marrë për emergjencat civile është 26,661,278 lekë, nga transfertat e kushtëzuar.</p> <p>6. A ka pasur një mbështetje vitet e kaluara? Nëse po, sa ka qenë vlera në lekë? Po, ka pasur dhe konkretisht për vitin 2020 ka qenë 5,022,209 lekë nga transfertat e kushtëzuar dhe në vitin 2021 në vlerën 3,829,735 lekë nga transfertat e kushtëzuar dhe 1,047,140 lekë nga transfertat specifike.</p>		
13.	28.05.2022	Kërkesë për t’u pajisur me informacion mbi vlerën e buxhetit të Bashkisë Korçë për zhvendosjen e mbetjeve drejt landfillit të Maliqit, a është e përballueshme kjo	02.06.2022	Kërkuesit i është vendosur në dispozicion i gjithë informacioni i kërkuar.	E plotë	S’ka tarifë

		kosto, sa fusha ka bashkia për depozitimin e mbetjeve dhe sa janë mbyllur, sa nga këto fusha janë rehabilituar etj				
14.	07.06.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion në lidhje me politikat sociale që janë ndjekur e ndiqen për punësimin, strehimin si dhe probleme të tjera sociale të komuniteteve romë dhe egjiptianë.	09.06.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 28.05.2022, ju bëjmë me dije se: 1.Sa është vlera e parashikuar në buxhet për zhvendosjen e mbetjeve drejt Landfillit të Maliqit dhe kostoja e përpunimit? Vlera e parashikuar në buxhet për zhvendosjen e mbetjeve drejt landfillit të Maliqit për vitin 2022 është 259,532 lekë. Kostoja e përpunimit është e njëjta me vlerën e parashikuar. 2.Si konsiderohet kjo kosto për buxhetet tuaja a është e përballueshme apo ju vendos në vështirësi? Kjo kosto është e përballueshme. 3.Sa fusha të hapura ka për depozitimin e mbetjeve në territorin e bashkisë dhe sa prej tyre janë mbyllur? Të gjitha fushat e hapura për depozitimin e mbetjeve aktualisht janë mbyllur, sepse çdo mbetje çohet tek landfilli i Maliqit. 4.Sa nga fushat e mbyllura janë rehabilituar?	E plotë	S'ka tarifë

				<p>Të gjitha fushat e fshatrave janë rehabilituar. Vetëm fusha e madhe e qytetit është për t'u rehabilituar.</p> <p>5.Në çmasë e ka zgjidhur menaxhimin e mbetjeve landfilli dhe me çfarë problematikash përballeni?</p> <p>Landfilli i Maliqit ka zgjidhur menaxhimin e të gjitha mbetjeve të Bashkisë Korçë në masën 100%.</p> <p>6.A depoziton bashkia në landfill mbetje inerte?</p> <p>Jo.</p> <p>7.A ka fushë të miratuar për inertet me vendim të Këshillit Bashkiak?</p> <p>Po.</p> <p>8.Po mbetjet organike ku depozitohen? A ka fusha të miratuara?</p> <p>Mbetjet organike kompostohen nëpër fshatra.</p> <p>9.Cilat janë kategoritë e mbetjeve që nuk depozitohen në landfill dhe cila është arsyeja?</p> <p>Mbetjet spitalore nuk depozitohen në landfill sepse ndjekin tjetër procedurë nga Ministria e Shëndetësisë.</p>		
15.	01.07.2022	Kërkesë për t'u pajisur me listën emërore të punonjësve në pozicione drejtuese të larguar/ne proces hetimor/ të dënuar për shkak të dekriminalizimit ose që	05.07.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 01.07.2022, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Nuk ka asnjë punonjës në pozicion drejtues të larguar/ në proces hetimor/ të dënuar për shkak të dekriminalizimit ose që kanë refuzuar plotësimin e formularit të dekriminalizimit për periudhën</p>	E plotë	S'ka tarifë

		të kenë refuzuar plotësimin e formularit të dekriminalizimit, si edhe listën emërore të këshillëtarëve bashkiakë që kanë refuzuar plotësimin e formularit të dekriminalizimit për periudhën 01.10.2019 deri në Qershor 2022.		01.10.2019 deri në Qershor 2022. Gjithashtu, nuk ka asnjë këshilltar bashkiak që ka refuzuar plotësimin e formularit të dekriminalizimit ose që të jenë larguar për shkak të dekriminalizimit.		
16.	07.07.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion në lidhje me masat që ka marrë bashkia këtë vit më tepër së vitin e kaluar për t'u përballur me zjarret, çfarë mjetesh disponon bashkia për neutralizimin e zjarreve në terrene malore, a ka rrezik të përsëritet e njëjta situatë si vitin e kaluar si edhe nëse ka nevojë për më shumë ndihmë dhe mbështetje nga pushteti qendror.	14.07.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 07.07.2022, ju bëjmë me dije se: 1.Bashkia Korçë për t'u përballur me zjarret në zonat pyjore ka shtuar mjetet zjarrfikëse si edhe ka hapur më shumë rrugë kalimi për të lehtësuar lëvizjen e makinave në zonat pyjore. 2.Bashkia Korçë disponon 8 automjete zjarrfikëse prej të cilave 4 automjete zjarrfikëse janë marrë në fillim të vitit 2022, si edhe një shkallë lëvizëse për ndërhyrje në hapësira të larta. 3.Nëse përsëritet e njëjta situatë mendojmë se i kemi siguruar mundësitë dhe aftësitë për të neutralizuar problematikën në kohë. 4.Po, ka nevojë për ndihmë të vazhdueshme nga pushteti qendror për të shtuar mjetet "e vogla" për të qarkulluar në rrugët ku mjetet e mëdha	E plotë	S'ka tarifë

				kanë vështirësi, si edhe për kualifikimin e personelit.		
17.	08.07.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion në lidhje me dëmshpërblimin nga ndërtime të bëra për hapjen e rrugës nacionale Korçë-Ersekë.	12.07.2022	Bashkia Korçë nuk është institucioni kompetent për dhënien e këtij informacioni.	E deleguar	S'ka tarifë
18.	26.07.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion në lidhje me buxhetin vjetor të planifikuar për rininë, sa meshkuj dhe femra të moshës 18-29 vjeç janë të punësuar në Bashkinë Korçë, sa është përqindja e të rinjve të punësuar krahasuar me numrin total të administratës, a ka bashkia politika rinore apo struktura rinore dedikuar grupmoshës 18-29 vjeç si edhe pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet	02.08.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 26.07.2022, ju bëjmë me dije se: 1. Bashkia Korçë ka të planifikuar në buxhetin e saj vjetor fonde për rininë duke përfshirë grupmosha të ndryshme. Buxheti i akorduar konsiston në zhvillimin e projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme gjatë vitit sipas programeve si: Sport dhe Argëtim, Zhvillimi i Turizmit, Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik dhe Arsimi i mesëm i përgjithshëm. Përqindja(%) e fondeve për rininë kundrejt buxhetit total është 2%. 2. Po, pranë bashkisë Korçë ka të punësuar individë të moshës 18-29 vjeç, prej të cilëve 19 janë femra dhe 16 janë meshkuj.	E plotë	S'ka tarifë

		publike të zhvilluara nga Bashkia Korçë.		<p>3. Përqindja e të rinjve të punësuar krahasuar me numrin total të administratës është 13.1%.</p> <p>4. Bashkia Korçë e ka konsideruar rininë si një nga prioritetet kryesore, duke krijuar ura bashkëpunimi me institucione dhe organizata jo-fitimprurëse. Janë hartuar projekte dhe aktivitete me fokus të rinjtë dhe ka qënë gjithmonë mikpritëse për ta. Bashkëpunimi disa vjeçar me Qendrën Rajonale Rinore Korçë ka bërë të mundur hartimin dhe implementimin e projekteve për t'iu dhënë zgjidhje problematikave lokale rinore. Gama e mbështetjes së të rinjve nga ana e bashkisë është e gjerë dhe kap shumë dimensione si nxitja për punësim, edukimi, sporti, kultura, vullnetarizmi etj.</p> <p>Qendra Sportive Korçë është një tjetër hapësirë multifunksionale, ku të rinjtë e grupmoshave të ndryshme zhvillojnë talentet e tyre në një gamë të gjerë disiplinash sportive. Vlen të përmendet investimi më i fundit i Bashkisë Korçë, "Korça Innovation Technology Hub", ku zhvillohen kurse, trajnime në fushën e programimit, teknologjisë dhe menaxhimit të rrjeteve sociale. Ky hub ju ofron mundësi të rinjve për t'u kualifikuar dhe më pas të punësohen në këtë treg, në botën digjitale.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

			<p>Plani Lokal i Veprimit për Rininë është hartuar në bashkëpunim me Bashkinë e Korçës, falë mbështetjes së plotë të Fondacionit Friedrich Ebert, i cili mbështet zhvillimin e politikave rinore në nivel vendor dhe qendror, në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar. Ky plan shërben si një bazë orientuese politikash dhe veprimtarie të dedikuar për sektorin e rinisë, në përputhje të plotë me perceptimet dhe vizionin që të rinjtë dhe institucionet kanë mbi perspektivën lokale.</p> <p>https://tirana.fes.de/fileadmin/user_upload/documents/Plani_lokal_i_veprimit_per_rinine_2020-2023_Korce.pdf</p> <p>Plani Lokal i Veprimit për Rininë është fokusuar në 6 prioritete, që janë përcaktuar si prioritete të rëndësishme edhe për Bashkinë e Korçës, të cilat janë:</p> <ol style="list-style-type: none">1- Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës;2- Punësimi dhe sipërmarrja rinore3- Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor;4- Art, sport, kulturë dhe mjedisi;5- Mbështetja e organizatave dhe nismave rinore;6- Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike për të rinjtë. <p>5-6. Në këtë aspekt Bashkia Korçë është në fazën e krijimit të strukturave rinore, po ashtu edhe të Këshillit Vendor Rinor.</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>Krijimi i një vendi të dedikuar për rininë (Janar 2021) brenda Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë është një tregues për rëndësinë e kësaj grupmoshe në prioritetet e bashkisë. Përmendim sektorin e teknologjisë dhe inovacionit i cili është i dedikuar në trajnimin dhe punësimin e të rinjve në fushën e përmendur. Vlen të theksohet një pjesëmarrje mbi 30 % e të rinjve në strukturën e Këshillit Bashkiak, të cilët përpos funksioneve dhe detyrave të tyre, janë advokues për çështjet dhe problematikat rinore në qytetin e Korçës.</p> <p>8. Të gjitha aktivitetet rinore, proceset konsultative, projektet me në fokus rininë të listuara më sipër Bashkia Korçë bashkëpunon me institucione/organizata në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Përmendim disa prej tyre.</p> <p>Nivel kombëtar: Qendra Rajonale Rinore në Korçë, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë, institucione të tjera publike, organizata të tjera lokale apo kombëtare të interesuara për të zhvilluar aktivitete të përbashkëta dhe ministritë e linjës.</p> <p>Nivel ndërkombëtar: UNDP, TERRE DES des Homes, UNICEF, USAID, World Vision, Eu4Innovation etj.</p> <p>Përmendim aktivitetet:</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>Projekti “Bursa për gjimnazistët”, që konsiston në vlerësimin moral dhe financiar të nxënësve ekselentë nga gjimnazet e Bashkisë Korçë.</p> <p>Projekti “Parku me materiale të riciklueshme”, që synon angazhimin e të rinjve të shkollave që të zbatojnë idetë e tyre inovative.</p> <p>Projekti “Idea Bombing”, që synon organizimin e një konkursi, ku të rinjtë pjesëmarrës, kanë mundësi të japin zgjidhje, ide apo të ngrenë dhe problematika që kërkojnë zgjidhje për qytetin e Korçës.</p> <p>Projekti “Ecim së bashku drejt aktivizmit rinor”, zbatuar nga organizata “Youth Act”, Tiranë në bashkëpunim me Bashkinë e Korçës dhe mbështetur financiarisht nga UNDP, Albania.</p> <p>Projekti “Upshift” është një program i cili ka si qëllim rritjen e mundësive për të rinjtë duke siguruar rritjen e mirëqënies nëpërmjet punësimit dhe sipërmarrjes. Ky program përmirëson gatishmërinë profesionale dhe kapacitetet e sipërmarrjes, për sa i përket aftësive të transferueshme dhe eksperiencave profesionale tek të rinjtë.</p> <p>Prejekti “iKorça Hackathon” u organizua nga Bashkia Korçë, me mbështetjen e projektit “EU for Innovation” dhe në bashkëpunim me</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>ICTS lab dhe Crazy Town. Rreth 40 studentë, kërkues nga universitete, anëtarë të stafit akademik, Startup-e dhe talente të tjera u bashkuan nga data 11-13 Dhjetor virtualisht dhe fizikisht për ekipet që vinin nga Korça. Eventu u mbajt në Bibliotekën e Re të qytetit, e cila tashmë është shndërruar në Korça ICT Hub. Gjatë Hackathon një serë shërbimesh, konceptesh, aplikacionesh, demosh dhe kërkimesh u prezantuan. Projekti “Agrichallenge” është një konkurs i organizuar nga Zhvillimi i Qëndrueshëm Rural në Shqipëri (SRD), i cili zbatohet në Shqipëri nga GIZ në bashkëpunim me Ministrinë Shqiptare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Bashkinë e Korçës dhe financuar nga Qeveria Gjermane (Ministria Federale Gjermane e Bashkëpunimit dhe Zhvillimi Ekonomik). Qëllimi kryesor i këtij programi është promovimi i aftësive sipërmarrëse tek të rinjtë në kuadër të përmirësimit të bujqësisë dhe agroturizmit në qarkun e Korçës. AgriChallenge nis si një seri ngjarjesh dhe aktiviteteve edukative, të përbërë nga seminare të ndryshme, kampe pune, të cilat finalizohen me Hackathone nën "AgriChallenge", për të mbështetur perspektivat e diversifikuara të të ardhurave në agroturizëm, agrobiznes</p>	
--	--	--	--	---	--

				dhe për të përmirësuar konkurrencën në sektorin e bujqësisë. 9. Përqindja e të rinjve në konsultimet publike është afërsisht 30%. Njoftimi i të rinjve bëhet nëpërmjet rrjeteve tona sociale si edhe faqes zyrtare të web-it, pasi kjo grupmoshë është më tepër aktive në përdorimin e tyre.		
19.	28.08.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi landfillin e mbetjeve, të dhëna teknike të tij, vlera e kontratës, vlera e shpenzuar për ndërtimin e landfillit etj	30.08.2022	Bashkia Korçë nuk është institucioni kompetent për dhënien e këtij informacioni.	E deleguar	S'ka tarifë
20.	01.09.2022	Kërkesë për tu pajisur me informacion mbi qendrën rinore dhe ceshtje të rinise per Bashkinë Korçë.	07.09.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 01.09.2022, ju bëjmë me dije se : 1. Për Qendrën Rajonale Rinore nuk është dhënë mbështetje financiare nga ana e bashkisë. 2. Qendra Rajonale Rinore u mbyll pas marrjes së vendimit të qeverisë Nr.681 datë 02.09.2022 "Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë". Bashkangjitur po ju vendosim në dispozicion një kopje të vendimit. 3. Ambienti i Qendrës Rajonale Rinore nuk është në pronësi të bashkisë Korçë. 4. Jo. 5. Plani Lokal i Veprimit për Rininë është hartuar në bashkëpunim me	E plotë	S'ka tarifë

			<p>Bashkinë e Korçës, falë mbështetjes së plotë të Fondacionit Friedrich Ebert, i cili mbështet zhvillimin e politikave rinore në nivel vendor dhe qendror, në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar. Ky plan shërben si një bazë orientuese politikash dhe veprimtarie të dedikuar për sektorin e rinisë, në përputhje të plotë me perceptimet dhe vizionin që të rinjtë dhe institucionet kanë mbi perspektivën lokale.</p> <p>https://www.festirana.org/fileadmin/user_upload/documents/Plani_lokal_i_veprimit_per_rinine_2020-2023_Korce.pdf Plani Lokal i Veprimit per Rininë është fokusuar në 6 prioritetë, që janë përcaktuar si prioritetë të rëndësishme edhe për Bashkinë e Korçës, të cilat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës; 2- Punësimi dhe sipërmarrja rinore; 3- Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor; 4- Art, sport, kulturë dhe mjedisi; 5- Mbështetja e organizatave dhe nismave rinore; 6- Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike për të rinjtë. <p>6. Bashkia Korçë ka të planifikuar në buxhetin e saj vjetor fonde për rininë duke përfshirë grupmosha të ndryshme. Buxheti i akorduar konsiston në</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>zhvillimin e projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme gjatë vitit sipas programeve si: Sport dhe Argëtim, Zhvillimi i Turizimit, Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik dhe Arsimi i mesëm i përgjithshëm. Përqindja (%) e fondeve për rininë kundrejt buxhetit total është 2%.</p> <p>7. Bashkia Korçë e ka konsideruar rininë si një nga prioritetet kryesore, duke krijuar ura bashkëpunimi me institucione dhe organizata jo-fitimprurëse. Janë hartuar projekte dhe aktivitete me fokus të rinjtë dhe ka qënë gjithmonë mikpritëse për ta. Bashkëpunimi disa vjeçar me Qendrën Rajonale Rinore Korçë ka bërë të mundur hartimin dhe implementimin e projekteve për t'iu dhënë zgjidhje problematikave lokale rinore. Gama e mbështetjes së të rinjve nga ana e bashkisë është e gjerë dhe kap shumë dimensione si nxitja për punësim, edukimi, sporti, kultura, vullnetarizmi etj.</p> <p>Qendra Sportive Korçë është një tjetër hapësirë multifunksionale, ku të rinjtë e grupmoshave të ndryshme zhvillojnë talentet e tyre në një gamë të gjerë disiplinash sportive. Vlen të përmendet investimi më i fundit i Bashkisë Korçë, "Korça Innovation Technology Hub", ku</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>zhvillohen kurse, trajnime në fushën e programimit, teknologjisë dhe menaxhimit të rrjeteve sociale. Ky hub ju ofron mundësi të rinjve për t'u kualifikuar dhe më pas të punësohen në këtë treg, në botën digjitale.</p> <p>Përmendim aktivitetet:</p> <p>Projekti “Bursa për gjimnazistët”, që konsiston në vlerësimin moral dhe financiar të nxënësve ekselentë nga gjimnazet e Bashkisë Korçë.</p> <p>Projekti “Parku me materiale të riciklueshme”, që synon angazhimin e të rinjve të shkollave që të zbatojnë idetë e tyre inovative.</p> <p>Projekti “Idea Bombing”, që synon organizimin e një konkursi, ku të rinjtë pjesëmarrës, kanë mundësi të japin zgjidhje, ide apo të ngrenë dhe problematika që kërkojnë zgjidhje për qytetin e Korçës.</p> <p>Projekti “Ecim së bashku drejt aktivizimit rinor”, zbatuar nga organizata “Youth Act”, Tiranë në bashkëpunim me Bashkinë e Korçës dhe mbështetur financiarisht nga UNDP, Albania.</p> <p>Projekti “Upshift” është një program i cili ka si qëllim rritjen e mundësive për të rinjtë duke siguruar rritjen e mirëqënies nëpërmjet punësimit dhe sipërmarrjes. Ky program përmirëson gatishmërinë profesionale dhe</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>kapacitetet e sipërmarrjes, për sa i përket aftësive të transferueshme dhe eksperiencave profesionale tek të rinjtë. Prejkti “iKorça Hackathon” u organizua nga Bashkia Korçë, me mbështetjen e projektit “EU for Innovation” dhe në bashkëpunim me ICTS lab dhe Crazy Town. Rreth 40 studentë, kërkues nga universitete, anëtarë të stafit akademik, Startup-e dhe talente të tjera u bashkuan nga data 11-13 Dhjetor virtualisht dhe fizikisht për ekipet që vinin nga Korça. Eventu u mbajt në Bibliotekën e Re të qytetit, e cila tashmë është shndërruar në Korça ICT Hub. Gjatë Hackathon një seri shërbimesh, konceptesh, aplikacionesh, demosh dhe kërkimesh u prezantuan. Projekti “Agrichallenge” është një konkurs i organizuar nga Zhvillimi i Qëndrueshëm Rural në Shqipëri (SRD), i cili zbatohet në Shqipëri nga GIZ në bashkëpunim me Ministrinë Shqiptare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Bashkinë e Korçës dhe financuar nga Qeveria Gjermane (Ministria Federale Gjermane e Bashkëpunimit dhe Zhvillimi Ekonomik). Qëllimi kryesor i këtij programi është promovimi i aftësive sipërmarrëse tek të rinjtë në kuadër të përmirësimit të bujqësisë dhe agroturizmit në qarkun e Korçës. AgriChallenge nis si një seri ngjarjesh</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>dhe aktiviteteve edukative, të përbërë nga seminare të ndryshme, kampe pune, të cilat finalizohen me Hackathone nën "AgriChallenge", për të mbështetur perspektivat e diversifikuara të të ardhurave në agroturizëm, agrobiznes dhe për të përmirësuar konkurrencën në sektorin e bujqësisë.</p> <p>8. Grupmosha 15-29 vjeç.</p> <p>9. Përfshihen të rinjtë që mbulon juridiksioni i Bashkisë Korçë.</p> <p>10. Qendra Sportive Korçë, Biblioteka e Qytetit, Korça Innovation and Technology Hub.</p> <p>11. KVR është miratuar në mbledhjen e fundit të Këshillit Bashkiak me Vendim Nr.122, datë 29.07.2022. Ky Këshill do të përbëhet nga 10 anëtarë.</p>		
21.	23.09.2022	Kërkesë për tu pajisur me informacion mbi buxhetin e 5 viteve të fundit të bashkisë Korçë, detyrimet e prapambetura dhe ndaj kujt janë të ndara si një zë për secilën prej tyre, tenderat e kryera gjate 3 viteve të fundit, numrin e punonjësve në	03.10.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 23.09.2022, ju bëjmë me dije se:</p> <p>1. Buxhetet e Bashkisë Korçë për 5(pesë) vitet e fundit i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të bashkisë www.bashkikorce.gov.al, link-u bashkangjitur https://sites.google.com/view/bashkiakorce/home/transparenca-dhe-</p>	E plotë	S'ka tarifë

		<p>total dhe të ndara sipas drejtorive dhe institucioneve në varësi,etj</p>	<p>Ilogaridhenia-ekonomiko-financiare/buxheti .</p> <p>2. Detyrimet e prapambetura janë dhënë në formë tabele.</p> <p>. Informacionin në lidhje me procedurat e prokurimit të kryera nga Bashkia Korçë gjenden në link-un më poshtë http://www.app.gov.al/regjistri-i-realizimeve/.</p> <p>4. Informacionin në lidhje me numrin e punonjësve e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të bashkisë www.bashkiakorces.gov.al, link-u bashkangjitur https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/mbi-organizimin-dhe-funksionimin-e-bashkisadministrata-e-bashkis.</p> <p>5. Lista e financimeve për 3 (tre) vitet e fundit është dhënë në formë tabele.</p> <p>6. Shërbimi i pastrimit të qytetit kryhet nga firma “Korsel”. Bashkia ka kontratë 5-vjeçare me këtë firmë, e cila ka 80 punëtorë që kryejnë shërbimin.</p> <p>7. Mbjettjet e Bashkisë Korçë depozitohen në landfillin rajonal të Maliqit.</p> <p>8. Bashkia Korçë gjeneron 53 ton mbetje në ditë dhe paguan në landfillin e Maliqit 1250 lekë për ton.</p> <p>9. Buxheti i planifikuar për vitin 2022 për mirëmbajtjen e shkollave 9- vjeçare është në vlerën 79,020 mijë lekë dhe</p>		
--	--	---	---	--	--

			<p>arsim i mesëm i përgjithshëm 27,578 mijë lekë, duke përfshirë edhe shërbime të tjera që ofrohen për to.</p> <p>10. Furnizimi me ujë të pijshëm është 24 orë për gjithë zonën e shërbimit.</p> <p>11. Tarifa e ujit të pijshëm në qytet është 72 lekë/m³ për familjarët dhe tarifa e kanalizimeve 42 lekë /m³.</p> <p>Në zonat rurale në varësi të zonës janë tre tarifa përkatësisht 38, 28 lekë/m³ për familjarët, në zonat rurale nuk ka tarifë për kanalizime.</p> <p>Tarifa fikse e shërbimit është 140 lekë në muaj.</p> <p>Tarifa e ujit të pijshëm në qytet është 140 lekë/m³ për entet private dhe tarifa e kanalizimeve 64 lekë /m³.</p> <p>Në zonat rurale tarifa është 100 lekë/m³, për entet private dhe nuk ka tarifë për kanalizime.</p> <p>Tarifa fikse e shërbimit është 140 lekë në muaj.</p> <p>Tarifa e ujit të pijshëm në qytet është 117 lekë/m³ për institucionet dhe tarifa e kanalizimeve 64 lekë /m³.</p> <p>Në zonat rurale tarifa është 117 lekë/m³, për institucionet dhe nuk ka tarifë për kanalizime.</p> <p>Tarifa fikse e shërbimit është 100 lekë në muaj.</p> <p>12. Paketën Fiskale e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të bashkisë www.bashkiakorçe.gov.al, link-u</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>bashkangjitur https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/transparenca-dhe-llogaridhenia-ekonomiko-financiare/paketa-fiskale.</p> <p>13. Sipërfaqja e gjelbër është 387,685 m².</p> <p>14. Rreth 30% e buxhetit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për vitin 2022 ose 65 milion lekë shkojnë për gjelbërimin.</p> <p>15. Vitet e fundit nuk janë blerë pemë, pasi pemët janë prodhim i fidanishtes së Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.</p> <p>16. Në lidhje me këtë pyetje kërkohet të na saktësohet se për cilën bibliotekë bëhet fjalë.</p> <p>17.18. Për informacion mbi këto dy pyetje duhet t'i ishite drejtuar Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Korçë. Duke qenë se bashkia nuk e ka këtë informacion e kemi deleguar pranë institucionit përkatës dhe ju kemi vendosur në dijeni edhe ju si kërkues.</p> <p>19. Të ardhurat e arkëtuara në Bashkinë Korçë nga institucionet e hotelerisë dhe akomodimit për 3 vitet e fundit janë: Viti 2020- 3,943,070 lekë Viti 2021- 5,956,660 lekë Viti 2022 deri në dt.19 shtator 2022- 5,329,083 lekë</p> <p>20. Këtë informacion e gjeni në link-un më poshtë:</p>		
--	--	--	---	--	--

				http://www.app.gov.al/regjistri-i-realizimeve/ .		
22.	09.10.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion në lidhje me projektin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit në të cilin është përfituese bashkia, cfarë parashikon projekti, sa është fondi i parashikuar nga AZHBR për këtë projekt etj	18.10.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 09.10.2022, ju bëjmë me dije se: 1. Projekti ka të bëjë me investim shtesë në tregun e gjësë së gjallë. Ky projekt parashikon përmirësim infrastrukture brenda tregut të gjësë së gjallë, të tilla si: asfaltim i rrugëve hyrëse-dalëse në treg dhe parkingut, shtresë betoni në të gjitha bokset ku vendosen kafshët, rrethimi me blloqe i të gjithë tregut, vendosje pusetash etj 2. Jo. 3. Fondi i përfituar nga AZHBR është 24.755.991 lekë. 6. Po, është hera e parë. 7. Shoqëria aksionare "Tregu i shitjes me shumicë fruta-perime" në të cilën ka aksione Bashkia Korçë është krijuar në vitin 2003. Kjo shoqëri ka si funksion dhënien me qira të hapësirave dhe ambienteve të tregut, individëve që tregtojnë prodhime bujqësore(fermerë,tregtarë), kryesisht fruta-perime. 8. Bashkangjitur po ju vendosim në dispozicion planimetrinë e projektit.	E plotë	S'ka tarifë

23.	11.10.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi numrin e fshatrave turistike të përfshirë në listën e projektit "100 Fshatrat", sa nga to kanë pasur investime dhe çfarë investime janë kryer, si edhe sa është fondi i këtyre investimeve.	14.10.2022	Kërkuesit i është vendosur në dispozicion informacioni i cili disponohej nga ana e Bashkisë Korçë .	E plotë	S'ka tarifë
24.	11.10.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi nivelin e ndotjes së ajrit në qytetin e Korçës si pasojë e ngrohjes me dru, cilat janë alternativat që ofron bashkia për të reduktuar përdorim e druve, a ka projekte konkrete që mund të jenë të zbatueshme në qytetin e Korçës etj	20.10.2022	<p>1. Si paraqitet situata e ndotjes së ajrit në qytetin e Korçës si pasojë e ngrohjes së popullsisë me dru? Monitorimi i cilësisë së ajrit urban bëhet nga AKM.</p> <p>2.Sa është niveli i ndotjes së ajrit nga përdorimi i druve dhe cilave të dhëna ju referohet bashkia për t'u informuar mbi nivelin e ndotjes? Në lidhje me cilësinë e ajrit, monitorimi i ajrit urban në stacionet automatike në qytetin e Korçës realizohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM). Ndotësi që prek njerëzit janë grimcat me madhësi PM 10 dhe PM 2.5, NO2, SO2, O3, CO.</p> <p>Ndotja e ajrit nuk është pasojë vetëm e përdorimit të druve, por ka dhe një sërë faktorësh të tjerë si: aktivitetet industriale, mjetet automobilistike dhe sasia e trafikut në përgjithësi, cilësia e</p>	E plotë	S'ka tarifë

			<p>lëndëve djegëse, etj Pra, nuk mund të ketë përcaktim të nivelit të ndotjes së ajrit vetëm nga përdorimi i druve të zjarrit.</p> <p>3. Në kushtet kur impakti negativ i përdorimit të druve për ngrohje është i shumëfishtë në shëndetin e popullatës, turizëm, mjedis etj cilat janë alternativat që ofron bashkia për të reduktuar përdorimin e druve? Bashkia është duke menduar një strategji për reduktimin e përdorimit të druve të zjarrit, por për shkak të një investimi shumë të madh kërkon një angazhim jo vetëm nga pushteti lokal, por edhe nga ai qendror.</p> <p>4. A ka projekte konkrete që mund të jenë të zbatueshëm në qytetin e Korcës? Jo, nuk ka projekte konkrete, por vetëm projekt ide në bashkëpunim dhe në konsultime të vazhdueshme me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.</p> <p>5. A ka konsultim me publikun për zbatimin e këtyre projekteve? Jo, sepse nuk ka ide konkrete.</p> <p>6. Bashkia e Korcës a informohet rregullisht nga institucionet që kanë detyrim të matin nivelin e ndotjes së ajrit në qytet? Nese po, ne cfare afatesh? Në lidhje me cilësinë e ajrit, monitorimi i ajrit urban në stacionet automatike në</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>qytetin e Korçës realizohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM). AKM nxjerr Raportin e Gjendjes në Mjedis për çdo vit (raport i publikuar në faqen zyrtare të AKM-së), ku midis të tjerave bën vlerësimin e gjendjes së cilësisë së ajrit urban.</p> <p>7. Cilat janë të dhënat e fundit të referuara dhe në çfarë date? Monitorimi e cilësisë së ajrit urban për vitin 2021 është kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në disa qytete kryesore të vendit (midis të cilave dhe Korça), për treguesit kryesorë të ndotjes së ajrit urban si: PM10, NO2, SO2, O3, CO.</p> <p>Nga ky monitorim për qytetin e Korçës është bërë vetëm vlerësimi i situatës nga ozoni (O₃) për periudhën Korrik-Gusht.</p> <p>Nuk ka matje që nga viti 2018 e në vazhdim për vlerat e PM 10 dhe PM 2.5 në qytetin e Korçës.</p> <p>8. A ka bashkia projekte të tjera konkrete për të reduktuar ndotjen e ajrit, në kushtet kur projektet që sigurojnë ngrohjen nga burime të tjera edhe nëse zbatohen zgjatin në kohë dhe kanë kosto madhore? - Një nga mënyrat për reduktimin e ndotjes së ajrit është edhe termoizolimi i banesave.</p>	
--	--	--	--	--

			<p>Është detyrimi ligjor që për çdo objekt që do të aplikojë për miratim leje ndërtimi dhe çertifikatë përdorimi të paraqitet raporti i auditimit të energjisë. Termoizolimi i banesave, sipas VKM-së nr.457, datë 29.06.2022, neni 6, pika 1, ii, "ndërhyrjet me qëllim ruajtjen apo rritjen e efikasitetit energjetic dhe akustike në një strukturë ekzistuese, ..." janë ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zëvendësimi i llampave jo eficiente me llampa Led. - Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra. <p>Ndërkohë është rritur numri i subjekteve që janë pajisur me deklaratë paraprake për vendosje panele fotovoltaikë.</p> <p>9. Cilat janë këto projekte?</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rikonstruksioni i rrjetit të ndriçimit rrugor në kuadrin e efikasitetit të energjisë në qytetin e Korçës. (zëvendësim i llampave jo eficiente me llampa Led, zëvendësim i rrjetit të infrastrukturës). - Termoizolimi i banesave shumëfamiljare në rrugët : “Niko Kovaçi”, “10 Korriku” e Blv.”Republika”. <p>Këto projekte janë financim i Agjencisë së Eficencës së Energjisë dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Qëllimi i investimit konsiston në termoizolim të mureve të jashtme, termoizolim</p>		
--	--	--	--	--	--

				dhe hidroizolim e tarracës dhe vendosjen e dritareve termike, etj.		
25.	24.10.2022	Kërkesë për t'u vendosur në dispozicion një kopje e kontratës mes Bashkisë Korçë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim AADF për krijimin e BID dhe TID, kopje e statutit të BID dhe TID, informacion se në çfarë kapaciteti është bashkia palë në këtë iniciativë, roli dhe fuqia vendimmarrëse si edhe cili kuadër ligjor është përdorur për krijimin e këtyre entiteteve.	02.11.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 24.10.2022, ju bëjmë me dije se: Bashkia Korçë aktualisht nuk ka ndonjë rol vendimmarrës apo menaxhues përsa i përket shoqatës BID dhe TID, kjo për shkak se as shoqata BID dhe as shoqata TID nuk janë transformuar sipas parashikimeve ligjore dhe konkretisht nenit 23 të Ligjit 63/2020 "Për përmirësimin e zonave të biznesit" dhe në këto kushte kur këto shoqata nuk zbatojnë detyrimin e përcaktuar në këtë ligj, ato vazhdojnë të operojnë për një qëllim tjetër me interes publik, por jo si një organizatë BID dhe TID.	E plotë	S'ka tarifë
26.	01.11.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi çështjet e mëposhtme: Bashkia dhe Shoqëria Civile, Bashkia në proceset e integritit evropian, Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe	04.11.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 01.11.2022, po ju vendosim në dispozicion informacionin e kërkuar: 1. Linkun e Programit të Transparencës ku gjeni të publikuar të dhënat mbi "Bashkinë në proceset e integritit evropian" https://sites.google.com/view/bashkiako	E plotë	S'ka tarifë

		<p>konsultimin publik, Planin Vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje si edhe Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje në vitin 2022.</p>	<p>r/home/informacion-tjet%C3%ABr/bashkia-n%C3%AB-proceset-e-integrimit-evropian?authuser=0 .</p> <p>2. Informacionin mbi pikën "Bashkia dhe shoqëria civile" e gjeni gjithashtu të publikuar në Programin e Transparencës, linku bashkangjitur: https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/informacion-tjet%C3%ABr/bashkia-dhe-shoq%C3%ABria-civile?authuser=1.</p> <p>3. Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik Larisa Katundi E-mail: larisakatundi@gmail.com Orari i punës: 08:00-16:00 Adresa: Kodi postar 7001, L.12, Blvd "Shën Gjergji", Nr.12, Korçë</p> <p>4. Konsultimet publike për projekt buxhetin dhe paketën fiskale për vitin 2023, nuk janë zhvilluar ende. Kalendarin e konsultimeve, mënyrat e konsultimit publikohen në faqen zyrtare të webit www.bashkiakor.gov.al, si edhe në Programin e Transparencës, tek rubrika "Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje".</p> <p>5. Informacionin mbi këtë pikë e gjeni të publikuar në Programin e Transparencës, po ju vendosim në dispozicion linkun: https://sites.google.com/view/bashkiakor/home/pjes%C3%ABmarrja-qytetare-n%C3%AB-vendimmarrje?authuser=1.</p>		
--	--	--	---	--	--

27.	08.11.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi planet e mbarështimit të hartuara nga ju nga viti 2015 deri në nëntor 2022. Për planet e miratuara kërkojmë një kopje të tij si dhe kopjen e miratimit të Këshillit Bashkiak.	14.11.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 08.11.2022, po ju vendosim në dispozicion Planin e mbarështimit për ekonominë pyjore "Sherrë-Panarit" të vitit 2019, si edhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.175 datë 26.12.2019 "Për miratimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Sherrë-Panarit".	E plotë	S'ka tarifë
28.	15.11.2022	Kërkesë për t'i vendosur në dispozicion hartat e planit të mbarështimit të pyjore në ekonominë pyjore Sherrë-Panarit të hartuara nga Bashkia Korçë, tabelat me parcelat dhe nënparcelat sipas ndarjes së re së bashku me sipërfaqet e tyre si edhe një kopje të programit në formatin Access në të cilin janë plotësuar të dhënat e përshkrimit parcelar.	23.11.2022	Kërkuesit i është vendosur në dispozicion harta e ekonomisë pyjore Sherrë-Panarit dhe i është sqaruar se listën me ngastrat e gjen në pjesën e shkruar të planit i cili i është dërguar më parë. Gjithashtu i është sqaruar se kopjen e programit në formatin Access nuk mund t'ja vendosim në dispozicion pasi është e gjithë kadastra pyjore e Bashkisë Korçë.	E plotë	S'ka tarifë
29.	15.11.2022	Kërkesë për t'u pajisur me informacion sa nga prioritetet e Kontratës Sociale të nënshkruar midis Bashkisë Korçë dhe shoqatës "Gruaja	25.11.2022	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 15.11.2022, nga të dhënat e mbledhura nga drejtoritë përkatëse të Bashkisë Korçë si edhe nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, po ju vendosim në dispozicion arritjet e	E plotë	S'ka tarifë

		<p>në Zhvillim”, janë përmbushur.</p>	<p>deritanishme për secilin prej prioriteteve të Kontratës Sociale.</p> <p>Prioriteti 1- Ndërhyrje me investime që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore, për Bashkinë Korçë në njësitë e mëposhtme:</p> <p>Rajoni 1: Është bërë riparim i trotuarëve si edhe përmirësimi i ndriçimit në rrugën “Theodhor Kavalioti”. Në kuadër të aksionit të pastrimit Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ka ndërhyrë për pastrimin e zonave problematike me ndotje në qytet dhe Njësitë Administrative dhe vazhdon punën për të mbajtur pastër çdo territor të Bashkisë Korçë.</p> <p>Rajoni 2: Është bërë asfaltimi i rrugëve Mihal Ciko, Naum Karanxha dhe Koli Çeku në lagjen 4 të qytetit si edhe trotuaret.</p> <p>Rajoni 3: Është bërë asfaltimi i rrugëve "Thanas Rëmaçka" dhe "Mujo Ulqinaku", në lagjen 6 të qytetit të Korçës si edhe i rrugëve në lagjen 18. Gjithashtu është bërë sistemimi i trotuarëve në këto rrugë.</p> <p>Njësia administrative Qendër Bulgarec</p>		
--	--	---------------------------------------	---	--	--

			<p>Aktualisht është asfaltuar rreth 80% e rrugëve të brendshme të fshatit Bulgarec si edhe rruga Bulgarec-Çiflig. Vitin e kaluar është pajisur me trotuar “Rruga e Krishterëve”. Në fshatin Bulgarec 90% e rrugëve të fshatit janë të pajisura me ndriçim publik. Gjithashtu, vijon puna për çakullimin e rrugëve të parcelave në fshatin Bulgarec, si edhe në të gjitha fshatrat e Bashkisë Korçë për t’u ardhur në ndihmë fermerëve për të lehtësuar punën e tyre.</p> <p>Njësia administrative Drenovë</p> <p>Drenova është pjesë e projektit "100 fshatrat" dhe një nga prioritetet e Bashkisë Korçë, për ta shndërruar atë ashtu si Dardha e Voskopoja, në një destinacion turistik. Pas punës për rehabilitimin e rrugës në një nga zonat më të veçanta në Shqipëri Parkut Kombëtar "Bredhi i Drenovës", një perlë e natyrës, është punuar brenda fshatit për përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Është bërë asfaltimi i rrugës nga shkolla deri në qendër si edhe rruga ”Pavlo Sholla”.</p> <p>Njësia administrative Mollaj</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>Është bërë asfaltimi i rrugëve “Haxhi Sherif dhe Xhamia”. Vijon puna për çakullimin e rrugëve të parcelave.</p> <p>Prioriteti 2- Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.</p> <p>Korçë</p> <p>Bashkia Korçë ka filluar punën për rikonstruksionin e plotë të Shkollës "Themistokli Gërmenji" në Korçë. Projekti përfshin transformimin rrënjësor të ambienteve, ndërtimin e një palestere të re, kabinetin e ri laboratorik dhe vendosjen e të gjitha paisjeve të nevojshme për zhvillimin e mësimin në standarde bashkëkohore.</p> <p>Njësia administrative Qendër Bulgarec</p> <p>Është realizuar shtimi i numrit të tualeteve në shkollën e fshatit Bulgarec dhe është drejt përfundimit puna për krijimin e një mjedisi me lojra ku fëmijët mund të argëtohen.</p> <p>Njësia administrative Drenovë</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>Nuk është ndërtuar ende këndi sportiv në shkollën e fshatit Mborje.</p> <p>Njësia administrative Mollaj</p> <p>Aktualisht kanë filluar punimet për ndarjen e tualeteve dhe izolimin e lagështisë në shkollën e fshatit Mollaj.</p> <p>Prioriteti 3- Nxitja e politikave të punësimit për të rinjtë nëpërmjet incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për ta.</p> <p>Një nga lehtësitë që u është ofruar të rinjve me qëllim nxitjen e biznesit është përjashtimi nga pagesat e tarifave për vitin 2022 të gjithë subjekteve të cilat do të zhvillojnë për herë të parë aktivitet dhe regjistrohen nga studentë të diplomuar në universitete brenda dhe jashtë vendit gjatë vitit 2020 dhe 2021. Numri i subjekteve të cilat kanë përfituar është 10.</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>Vizioni i Bashkisë Korçë është kthimi i Korçës në kryeqendër të teknologjisë dhe inovacionit. Për këtë arsye është fokusuar në trajnimin dhe punësimin e të rinjve në tregun global për të punuar si freelancer në kompani të ndryshme të botës. Një numër i caktuar i trajnimeve janë financuar nga buxheti i Bashkisë. Gjatë 2022 janë trajnuar mbi 200 të rinj në fusha të ndryshme të inovacionit si: Social Media Manager, Web Programming, Adobe Illustrator, programim si (Java, Python) dhe mbi 15% e të rinjve janë punësuar pas përfundimit të kurseve. Bashkia Korçë është gjithashtu mbështetës për bizneset e para start up.</p> <p>Prioriteti 4- Rritja e ndihmës për grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror</p> <p>Prioriteti 5- Trajtim me prioritet i programeve që nxisin përmirësimin e kushteve të jetesës, strehimin dhe integrimin në punë dhe shoqëri të komunitetit Rom dhe Egjiptian</p> <p>Në Bashki është ngritur Qendra ditore e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në të cilën marrin shërbim 30 fëmijë.</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>Në vëmendje të Prioritetit 4 dhe 5, strehimi mbetet një nga sfidat me objekt evidentimin dhe zgjidhjen e problematikave për familjet në nevojë për strehim. Bashkia Korçë, struktura përkatëse Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimi i Banesave Sociale me Qera ka synuar rritjen e ndihmës për strehim të përshtatshëm nëpërmjet zbatimit të programeve të strehimit social, konkretisht "Përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet e varfëra dhe të pafavorizuara", duke e rritur numrin e përfituesve nga viti në vit. Nga zbatimi i projektit për vitin 2021 kanë përfituar rreth 80 familje në 9 objekte, banesa kolektive dhe për vitin 2022 përfitojnë rreth 120 familje në 12 objekte banesa kolektive.</p> <p>Për familjet e strehuara në zonat e ish Gjeologjikes, konvikti i shkollës bujqësore apo ish konvikti i ndërtimit sugjerojmë zgjidhje nëpërmjet instrumentit financiar të subvencionimit të qirasë sociale, individët/familjet e strehuara në këto objekte të sigurojnë një kontratë të qiradhënies dhe më pas të mbështetet me pagesën e qirasë për strehim në kushtet e një apartamenti në përputhje me të gjitha parimet e strehimit social.</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>Prioriteti 6- Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv për Buxhetimin me Pjesëmarrje, për të identifikuar sa më shumë problematika që lidhen me komunitetin, të marrë këndvështrimin e qytetarëve mbi vendimmarrjet më të rëndësishme.</p> <p>Bashkia Korçë në kuadër të programit “Bashkia për qytetarët” organizon çdo vit “Buxhetimin me pjesëmarrje”. Buxhetimi me pjesëmarrje është një mekanizëm që lejon qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrje dhe ngritjen e transparencës në procesin e hartimit të buxhetit. Në takimet e hapura që zhvillohen me banorët e qytetit dhe njësisive administrative qytetarëve u krijohet mundësia për të diskutuar mbi projektbuxhetin dhe Paketën Fiskale. Kjo praktikë financiare ka për qëllim të rritë pjesëmarrjen e zërit të qytetarëve, si dhe ndihmon qeverisjen vendore për të përmirësuar përgjegjësinë mbi buxhetin. Buxhetimi me Pjesëmarrje i ofron mundësinë qytetarëve për të vendosur së bashku me pushtetin vendor për prioritetet më të rëndësishme në zonën ku ata banojnë.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>Në datë 15.11.2022, u zhvillua në bashki një takim me përfaqësues të Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm të Shqipërisë, me përfaqësues të biznesit të madh, ekspertë kontabël dhe anëtarë të bordeve të zonave të biznesit BID dhe TID. Gjatë këtij takimi u diskutua për Paketën Fiskale të vitit 2023, evidentimin e sfidave për të ardhmen si dhe propozime për nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin e ardhshëm. Gjithashtu kanë filluar nga data 21.11.2022 dhe do të vazhdojnë të zhvillohen në ditët në vazhdim takimet e “Buxhetimit me Pjesëmarrje”, për të diskutuar mbi projektbuxhetin dhe Paketën Fiskale për vitin 2023 me banorë të qytetit dhe njësive administrative. Njoftimi bëhet në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë www.bashkiakorce.gov.al, si edhe në faqet e rrjeteve sociale.</p>		
30.	17.11.2022	Kërkesë për t’u pajisur me informacion mbi vlerën e investimit të Parkut Olimpik, kur ka filluar dhe kur ka përfunduar, çfarë përfshinte projekti për ndërtimin e Parkut Olimpik, për çfarë aktivitete shfrytëzohen hapësirat	02.12.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 17.11.2022 pas informacioneve të marra nga Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës si edhe Qendra Sportive Korçë sh.a, ju bëjmë me dije se:</p> <p>1. Sa është vlera e investimit të Parkut Olimpik të Korçës?</p> <p>- Vlera e investimit është 368.000.000 lekë.</p>	E plotë	S’ka tarifë

		<p>e dhe ambjentet, cilat janë aktivitetet kryesore lokale dhe kombëtare të zhvilluara, etj</p>	<p>2. Kur ka filluar ndërtimi dhe kur ka përfunduar? - Investimi ka filluar në vitin 2016 dhe ka përfunduar në vitin 2017.</p> <p>3. Çfarë përfshinte projekti për ndërtimin e Parkut Olimpik? - Ndërtimin e fushave sportive (futbolli, volejboli, basketbolli, tenisi, pist e atletike)</p> <p>4. Për çfarë aktivitetesh shfryëzohen hapësirat dhe ambjentet e Parkut Olimpik?</p> <p>5. Cilat janë disa prej aktiviteteve kryesore lokale dhe kombëtare të zhvilluara prej hapjes së tij?</p> <p>6. A janë zhvilluar aktivitete ndërkombëtare dhe nëse po, të çfarë natyre kanë qenë?</p> <p>7. Sa dhe si ka ndikuar ndërtimi i Parkut Olimpik në zhvillimin e sportit por edhe turizmit.</p> <p>- Qendra Sportive Korçë shfrytëzon hapësirat dhe ambjentet për aktivitete sportive, artistike dhe kulturore duke përfshirë thuajse të gjitha grupmoshat nga 3 deri në 80 vjeç.</p> <p>Aktivitetet sportive përfshijnë në masë të gjerë futbollin, basketbollin, volejbollin, tenis dhe atletikën. Sporte të tjera që i shtohen Qendrës disa herë gjatë vitit janë: taekwondo, handball, pingpong, badminton etj.</p>		
--	--	---	--	--	--

			<p>Në të gjitha këto disiplina zhvillohen gjatë gjithë vitit kampionate zyrtare dhe amatore, kombëtare dhe ndërkombëtare sipas një kalendari të përcaktuar.</p> <p>Qyteza e Fëmijëve shfrytëzon ambientet e saj duke ofruar kurse dhe programe të shumta çdo ditë duke përmendur disiplina si: basketbolli, volejboli, muzika, piktura, kitara, violina, kërcimi, vizatimi, art & craft, shkencë, matematikë, kinema etj.</p> <p>Qendra Sportive Korçë sh.a frekuentohet mesatarisht nga 500-600 fëmijë dhe të rinj çdo ditë.</p> <p>8. Çfarë u bë me projektin e Bashkisë së Korçës që parashikonte menaxhimin e Parkut Olimpik nga klubi i Interit?</p> <p>9. A ka një marrëveshje mes Bashkisë së Korçës dhe klubit italian të Interit? Nëse po, çfarë parashikon kjo marrëveshje? Nëse jo, pse nuk u arrit marrëveshja me klubin e Interit? Kush u bë pengesë për mos arritjen e marrëveshjes?</p> <p>Nuk u bë e mundur arritja e një marrëveshjeje për shkak se i tejkalonte mundësitë financiare.</p> <p>10. Nga kush është menaxhuar këto 4 vite, prej përfundimit të projektit Parku Olimpik?</p> <p>11. Kush e menaxhon aktualisht Parkun Olimpik?</p> <p>- Forma Ligjore: Shoqëri aksionere Shtetërore (SH.A) ku 100% aksionere</p>	
--	--	--	---	--

				<p>është Bashkia Korçë, prej përfundimit të projektit deri sot.</p> <p>12. A ka bashkia projekt për të ndryshuar mënyrën e menaxhimit të deritanishëm të Parkut Olimpik?</p> <p>- Jo.</p>		
31.	30.11.2022	<p>Kërkesë për informacion mbi lekët që ka shpenzuar Bashkia për dekorimin e qytetit në muajin Dhjetor 2021, sa përqind e buxhetit është shpenzuar për dekorimin e qytetit në fundvitin e kaluar, sa ishte buxheti i bashkisë në vitin 2021, sa lekë po shpenzon bashkia këtë vit për dekorimin e qytetit me rastin e festave të fundvitit si edhe buxheti i bashkisë për vitin 2022.</p>	05.12.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 30.11.2022, po ju vendosim në dispozicion informacionin e marrë nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK:</p> <p>1. Sa para ka shpenzuar Bashkia Korçë për dekorimin e qytetit në dhjetorin e vitit 2021 (me rastin e festave të fundvitit)?</p> <p>Bashkia Korçë ka shpenzuar për dekorimin e qytetit vlerën prej 5,383,300 lekë, nga të cilat 954,000 sponsorizim për festat e fundvitit nga Banka Raiffeisen dhe 4,429,300 lekë nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dekore dhe materiale ndihmëse për festat.</p> <p>2. Sa përqind e buxhetit të bashkisë është shpenzuar për dekorimin e qytetit në fundvit vitin e kaluar?</p> <p>Është shpenzuar 0,23% e buxhetit.</p> <p>3. Sa ishte buxheti i bashkisë më vitin 2021?</p> <p>Buxheti i bashkisë për vitin 2021 =1,942,685,590 lekë.</p>	E plotë	S'ka tarifë

				<p>4. Sa para po shpenzon bashkia këtë vit për dekorimin e qytetit me rastin e festave të fundvitit? Nëse ende nuk ka nisur dekorimi i qytetit, sa parashikohet të investojë në zbukurime?</p> <p>Për vitin 2022 Bashkia Korçë po shpenzon për dekor vlerën 4,695,600 lekë.</p> <p>5. Sa është buxheti i Bashkisë Korçë për vitin 2022?</p> <p>Buxheti i bashkisë për vitin 2022 = 2,138,489,707 lekë.</p>		
32.	06.12.2022	<p>Kërkesë për t'u pajisur me informacion mbi buxhetin për vitet 2020,2021 dhe 2022 për shërbimet për PAK, cilat janë shërbimet që i ofrohen këtij segmenti të popullsisë, cilat janë programet sociale që ka bashkia për PAK dhe a ka pasur probleme për zbatimin e këtyre programeve sociale.</p>	14.12.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion datë 06.12.2022, ju bëjmë me dije se:</p> <p>1. Sa është buxheti vjetor për vitet 2020, 2021 dhe 2022 për shërbimet për persona me aftësi të kufizuara në qytet?</p> <p>- Qendra Ditore Atelie</p> <p>Buxheti vjetor për vitin 2020 është 2450.000 lekë.</p> <p>Buxheti vjetor për vitin 2021 është 2550.000 lekë.</p> <p>Buxheti vjetor për vitin 2022 është 2390.000 lekë.</p> <p>- Qendra Publike Rezidenciale e Zhvillimit</p> <p>Buxheti vjetor për vitin 2020 është 12.600.000 lekë.</p> <p>Buxheti vjetor për vitin 2021 është 12.600.000 lekë.</p> <p>Buxheti vjetor për vitin 2022 është 11.340.000 lekë.</p>	E plotë	S'ka tarifë

			<p>- Qendra Komunitare e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara</p> <p>Buxheti vjetor për vitin 2021 është 54.249 lekë.</p> <p>Buxheti vjetor për vitin 2022 është 273.491 lekë.</p> <p>2. Cilat janë shërbimet që bashkia i ofron këtij segmenti të popullsisë?</p> <ul style="list-style-type: none"> -Logopedi -Fizioterapi -Terapi Zhvillimi -Këshillim -Riintegrim nëpërmjet punës -Vakt ushqimor -Aktivitete sociale -Mësimdhënie -Sigurimi i pjesëmarrjes në çdo projekt që zbaton Drejtoria e Kujdesit Social <p>3. Cili është shërbimi i cili zë vendin më të madh në shpenzimet vjetore? Përgjigjen më të detajuar për këtë pyetje e gjeni tek Pyetja 1.</p> <p>4. A ka bashkia programe sociale për personat me aftësi të kufizuara? Bashkia ka miratuar me Vendim Këshilli Bashkiak "Planin e Mbrojtjes Sociale", në të cilin përfshihen programet sociale për PAK. Ky plan gjendet i publikuar në faqen zyrtare të web-it www.bashkiakorce.gov.al, tek link-u bashkangjitur të cilin po ja u vendosim në dispozicion https://bashkiakorce.gov.al/files4users/fi</p>	
--	--	--	--	--

				<p>les/Plani%20i%20Mbrojtjes%20Sociale.pdf.</p> <p>5. A ka pasur probleme në zbatimin e këtyre programeve sociale? Cilat janë problemet më shqetësuese? Nuk ka pasur probleme.</p>		
--	--	--	--	--	--	--